

AKTI I THEMELIMIT

DHE

STATUTI I SHOQËRISË

AGE&CO SHPK

THEMELIMI

Neni 1

1.1 Shoqëria AGE&CO SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar , sipas Ligjit nr.9901, datë 14. 04. 2008 "Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare",më datë 01/11/2019.

1.2 Ortakët e shoqërisë janë si me poshtë:

1. Z. Andri Gjoka, i biri i Gentjanit dhe Jonides, shtetas Shqiptar, lindur më 09.08.2021, në Tiranë, banues në Rr. "Komuna e Parisit", Tiranë, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr.Personal K10809052Q.

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

Neni 2

Emërtimi

2.1 Emërtimi i ligjor i shoqërisë është "AGE&CO" shpk (në vijim Shoqëria)

Neni 3

Forma Ligjore

3.1 AGE&CO Shpk, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar shqiptar në Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjeter në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4

Baza ligjore

4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

Neni 5
Kohëzgjatja e veprimtarisë

5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon-me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB").

5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është për një afat të papërcaktuar.

Neni 6
Selia

6.1 Selia e shoqërisë është në adresën : Rruga "Komuna e Parisit" Zona kadastrale 8260 Numri i pasurise 6/330+1-N10 Tiranë.

6.2 Administratori i shoqërisë mund të vendosë të hapë degë dhe/ose filiale dhe/ose adresa sekondare dhe/ose zyra përfaqësimi të shoqërisë si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj. Gjithshtu të çrregjistrojë ato ekzistuese sipas ligjeve në fuqi.


6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera që ekzistojnë ose të krijohen në të ardhmen në Shqipëri dhe/ose jashtë saj me vendim të Administratorit të shoqërisë.

Neni 7
Emblema.Vula

7.1 Shoqëria do të ketë emblemën dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.

7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.

7.3 Të gjitha dokumentat e shoqërisë duhet të përbajnë emblemën dhe vulën e saj.



**Neni 8
Objekti**

8.1 Objekti I veprimtarisë së shoqërisë është : Shërbime taksi. Sherbime transporti urban dhe nderqytetas te udhetarëve, në përputhje me çdo ligj të zbatueshëm dhe rregulloreve të fushës përkatëse. Tregti dhe dhënie me qira e automjeteve. Kryerjen e të gjithë operacioneve industriale, tregtare, mobiliare dhe imobilare, për realizimin e qëllimit për të cilin është krijuar shoqëria. Çdo veprimtari tjetër ekonomike te nevojshme dhe te dobishme për realizmin e qëllimit të Shoqërisë e që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

8.2 Objekti I shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të ortakëve.

**Neni 9
Kapitali**

9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) Lekë. Kapitali ndahet në 1 (një) kuotë.

9.2 Kapitali fillestar është shlyer tërësisht nga ortakët e shoqërisë.

9.3 Kuota e pjesëmarrjes janë në zotërim si më poshtë :

a) Andri GJOKA, me përqindje pjesëmarrëse 100%


**Neni 10
Transferimi i kuotave. Kufizimet.**

10.1 Kuotat mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me amendimet përkatëse.

10.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi kuotat në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e ortakëve të shoqërisë.

**Neni 11
Rritja e kapitalit**

11.1 Kapitali I Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të ortakëve..



11.2 Zmadhimi I kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të ortakëve.

Neni 12
Zvogëlimi i kapitalit

12.1 Zvogëlimi I kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.

12.2 Propozimi I zvogëlimit do t'I paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë dpërpara marries së vednimit nga ortakët e shoqërisë. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'I paraqesin ortakëve të shoqërisë raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.

12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të ortakëve të shoqërisë.


ORGANET E SHOQËRISÉ

Neni 13
Vendimet e e ortakëve të shoqërisë

13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga ortakët e saj.

13.2 Vendimet e ortakëve përfshijnë kryesisht :

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë
- Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;
- Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;
- Miratimin e bilancit të shoqërisë e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Transformimin e shoqërisë në forma të tjera;



Neni 14
Administrimi

14.1 Administrimi I shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të ortakëve.

14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e ortakëve të shoqërisë.

14.3 Administratori i shoqërisë është Z. Andri Gjoka, i biri i Gentjanit dhe Jonides, shtetas Shqiptar, lindur më 09.08.2021, në Tiranë, banues në Rr. "Komuna e Parisit", Tiranë, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. Personal K10809052Q.

14.4 Administratori është përgjegjës për veprimtarinë e mëposhtme :

Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;


Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënet me të tretët personalisht ose me përfaqësim; Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;

Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zotëron;

Të zhvillojë veprimtari të tjera të çdo lloj natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj;

- Të përfaqesojë shoqërinë në Shqipëri tek palët e treta, institucione apo entitete publike ose private;
- Të lidhë për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palët e treta;
- Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet I nevojshëm përmbarëvajtjen e biznesit në shqipëri;
- Të vendos për ndryshimin e selisë së shoqërisë;
- Të përfaqesojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë çdo transaksion banker në emër të shoqërisë;
- Të ndërmarrë çdo veprimtari tjetër ose biznes ose aktivitet I cili kosniderohet I nevojshëm përmbarëvajtjen e shoqërisë në shqipëri.

14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për një afat 5(pesë) vjeçar me të drejtë ripëertëritje ose deri ne çastin e revokimit të tij me vendim të ortakëve të shoqërisë.



Neni 15

Viti finansiar

15.1 Viti finansiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar 31 Dhjetor të çdo viti.

15.2 Si përjashtim, viti i parë finansiar I shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 16

Bilanci, Kontabiliteti

16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga ortakët e shoqërisë dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatumore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.

16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.

16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë.

Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekoje pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të ortakëve.


Neni 17

Të Ardhurat, Dividenti

17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund t’I kalojnë të vetëm.

17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe ortakët do të përgjigjen deri në kufirin e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.



Neni 18

Likuidimi

- 18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e ortakëve të shoqërisë.
- 18.2 Me vendimin të ortakëve të shoqërisë caktohet një likudator ose një grup likudatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.
- 18.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjendjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohënn që nevojitet për përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedure, ortakët e shoqërisë do të shqyrtojnë bilancin përfundimtar dhe do të miratojnë përfundimin e procedurave të likuidimit.

Neni 19

Mosmarrëveshjet

- 19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t’I nënshtronen shqyrtimit nga gjykata/gjykatat kompetente në Republikën e Shqipërisë.

Neni 20

Klauzolë mbyllëse

- 20.1 Ky statut hartohet në 4(katër) kopje me fuqi të njëjtë ligjore.

Tiranë, datë 14/01/2025

ORTAKËT E SHOQËRISË

AGE&CO SHPK

Z.Andri Gjoka

